

## Kjo fletëpalosje është përpiluar nga:

- Qendra Familjare Werl Nord
- Qendra Familjare OMP Rasselbande Geseke
- Qendra Familjare Haus für Kinder Warstein
- Qendra Familjare Strolchhausen Geseke
- Qendra Familjare Marianne - Heese Werl
- Qendra Familjare Rappelkiste Warstein
- Qendra Familjare Senfkorn Geseke
- Qendra Familjare në Wiesengraben Soest
- Këshillimorja profesionale Jetimorja e Qarkut Soest
- Këshillimorja profesionale e Qytetit Lippstadt
- Qendra Komunale për Integrim Qarku Soest

## Dëshmitë e fotografive:

Fotografia e kopertinës: © Robert Kneschke – Fotolia.com

Ikonat:

© reeel – Fotolia.com (1, 5, 6)

© Matthias Enter – Fotolia.com (2, 3, 4, 7)

© Dejan Jovanovic – Fotolia.com (8)

### Herausgeber:



Kommunales  
Integrationszentrum  
Kreis Soest

Hoher Weg 1-3

59494 Soest

Telefon: 02921 30-2844

Fax: 02921 30-3493

[integrationszentrum@kreis-soest.de](mailto:integrationszentrum@kreis-soest.de)

[www.zuhause-im-kreis-soest.de](http://www.zuhause-im-kreis-soest.de)

gefördert durch:

Ministerium für Kinder, Familie,  
Flüchtlinge und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für  
Schule und Bildung  
des Landes Nordrhein-Westfalen



# KREIS SOEST



Kommunales  
Integrationszentrum  
Kreis Soest

Si mund ta regjistroj  
fëmijën tim  
në një institucion parashkollor?

Një guidë për prindër  
me origjinë migracioni

Albanisch



Südwestfalen

ALLES ECHT!

## Hapat për regjistrim në institucione parashkollore


### Të dashur prindër dhe kujdestarë ligjorë,


Nga kjo tabelë mund të mësoni se për cilat periudha janë të caktuar hapat që duhet ndjekur për të regjistruar fëmijën Tuaj në institucion parashkollor (çerdhe). Ju lutemi vini re se bëhet fjalë për një orientim fillestar dhe se periudhat kohore dhe afatet mund të variojnë varësisht nga qyteti/komuna dhe çerdhja. Në faqen tjetër i gjeni sqarimet lidhur me pikat e përmendura. Nëse keni pyetje, Ju lutemi drejtohuni çerdhes!


Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhejt.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	
																Dita e parë në përkujdesje
																Nënshkrimi dhe dorëzimi i kontratës për përkujdesje
																Takim njoftues për prindër në çerdhe
																Biseda e parë dhe pranuese ose vizita e parë në çerdhe
																Pranimi/mospranimi në vendin e dëshiruar të përkujdesjes
																Kërkimi i çerdheve të tjera
																Bisedë personale në çerdhen e dëshiruar
Kontaktimi me udhëheqësinë e çerdhes së dëshiruar (gjatë gjithë vitit)																
Kërkesa/Dërgimi i kartelës së çerdhes (kërkesa e mundur gjatë gjithë vitit)																
Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjet.	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	

## Hapat më të rëndësishëm për regjistrim në çerdhe

### Lista e kontrollit


- Kërkesa/Dërgimi i kartelës së çerdhes**  Për regjistrim në një çerdhe në Qarkun Soest (përfshirë Warstein) është e domosdoshme kartela e çerdhes. Nëse fëmija Juaj deri më 1 nëntor të vitit të ri parashkollor i ka mbushur dy, gjejësiht tri vjet (varësisht nga seksioni kompetent i rinisë në qytetin/komunën Tuaj), ju do të pranoni me postë një kartelë të çerdhes. Për fëmijët më të ri në moshë, kërkesën për lëshim të kartelës mund ta bëni në seksionin kompetent të rinisë.


- Kontaktimi i udhëheqësisë së çerdhes së dëshiruar**  Për regjistrim të fëmijës Tuaj kontaktoni udhëheqësinë e institucionit parashkollor dhe caktoni një takim për një bisedë personale informative.


- Biseda personale në çerdhen e dëshiruar**  Në këtë bisedë Ju dhe fëmija Juaj mund të njoftoheni me çerdhen. Ju i shihni hapësirat së bashku dhe e keni mundësinë për të parashtruar pyetje. Nëse Ju pëlqen institucioni, e plotësoni kartelën e çerdhes (të dhënat personale, tri institucione të dëshiruara brenda qarkut ku gjendet seksioni i rinisë, hapësira kohore e dëshiruar për përkujdesje) dhe e dorëzoni në çerdhe. Ju lutem keni parasysh afatin e dorëzimit! Informatat lidhur me afatet i gjeni në çerdhe.


Përveç kësaj Ju pranoni formularin e regjistrimit. Çerdhja mund t'ju ndihmojë gjatë plotësimit të formularit. Ju lutemi, sipas nevojës, me vete në takim sillni:


- Dokumentacionin e letërnjoftimit (për Ju dhe fëmijën Tuaj)
  - Librezën e kontrollit (nëse e keni)
- Eventualisht disa dokumente duhet t'i sillni tek më vonë, pyetni në çerdhe se çfarë duhet të sillni me vete.

- Kërkimi i çerdheve të tjera**  Ekziston mundësia që në institucionin e parë të dëshiruar nuk ka vende të përkujdesjes. Ju mund/duhet të kërkoni vend në disa çerdhe.

- Pranimi apo mospranimi për vendin e dëshiruar të përkujdesjes**  Për vendin e dëshiruar të përkujdesjes Ju merrni një konfirmim pranimi, apo mospranimi. Në rast të një mospranimi Ju do të këshilloheni nga ana e seksionit të rinisë për mundësi të tjera të përkujdesjes. Kjo mund të jetë përkujdesja e ofruar nga një çerdhe tjetër që gjendet brenda qarkut të seksionit kompetent të rinisë, apo përkujdesje e ofruar nga një person kompetent. Në rast të pranimit Ju në një periudhë të mëvonshme e lidhni një kontratë për përkujdesje me bartësin e çerdhes.

- Biseda e parë dhe pranuese dhe vizita e parë në çerdhe**  Ekspertët pedagogjikë të çerdhes do të flasin me Ju lidhur me zhvillimin e deritanishëm të fëmijës Tuaj, vetitë, zakonshmëritë e gjumit dhe ngrënies etj. (informohuni paraprakisht rreth dokumenteve të nevojshme për këtë bisedë).

- Takimi njoftues për prindër në çerdhe**  Gjatë takimit njoftues Ju, bashkë me prindërit e tjerë merrni informata të rëndësishme.

- Dita e parë në përkujdesje**  Me ditën e parë në çerdhe fillon koha e adaptimit, gjatë së cilës Ju dhe fëmija Juaj mund të familjarizoheni me vijimin e fëmijës në çerdhe.

**Udhëzim:** Nëse Ju nuk ndiheni ende të sigurtë të shprehni në gjuhën gjermane, në takim merreni me vete një person që do të përkthejë për Ju (p.sh. familjar/e, apo mik/e), ose luteni çerdhen për të organizuar një ndërmjetësues gjuhësor.